

Përmes bashkëpunimit teknik dhe ndihmës me grante, JICA ka qenë aktive në fushën e infrastrukturës mjedisore dhe rritjen e kapaciteteve, si dhe në harmonizimin e bashkëpunimit ndëretnik ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE PËR KONTROLLIN E NDOTJES SË AJRIT FAZA 2

Skema: Bashkëpunimi Teknik

Periudha e projektit:

qershor 2022 deri qershor 2026

Organizata homologe:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ndodja e ajrit në zonat urbane të Kosovës është bërë një problem serioz mjedisor për shkak të emetimeve nga termocentralet me linjtë, burimet stacionare të banimit si ngrohja dhe gatimi, si dhe automjetet, dhe efekti i tij në shëndetin e njerëzve është një shqetësim i madh. Përveç kësaj, kërkohet respektimi i standardeve të cilësisë së ajrit të ambientit të BE-së, por Kosova ka ngecje edhe në këtë aspekt.

Për më tepër, Kosova ka kërkuar fuqishëm ndihmë për zhvillimin e kapaciteteve dhe mbështetje për krijimin e sistemeve dhe strukturave të nevojshme për të ndi-

hmuar në përbushjen e obligimeve të BE-së, në të cilat Kosova aspiron të hyjë në të ardhmen. Në këto rrethana, JICA ka vazhduar përpjekjet për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve për të kontrolluar ndotjen e ajrit në Kosovë dhe ka filluar zbatimin e "Projektit të Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Kosovë Faza 2" me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve për menaxhimin e cilësisë së ajrit bazuar në dëshmitë teknike përmes krijimit të skenarëve të ardhshëm dhe vlerësimit të efektivitetit të masave të bazuara në këtë dëshmi shkencore.



PROJEKTI PËR RITJEN E KAPACITETEVE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE DREJT NJË SHOQËRIE TË QËNDRUESHME PËR RECICLIMIN E MATERIALEVE - CIKLI FAZA 2

Skema: Bashkëpunimi Teknik

Periudha e projektit:

korrik 2021 deri në korrik 2024

Organizatata homologe: **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Komunitatet e Malishevës, Rahovecit, Suharekës dhe Dragashit**

Që nga viti 2011, JICA ka mbështetur përmirësimet e menaxhimit të mbeturinave duke përfshirë donacionin e kamionëve grumbullues në Komunën e Prizrenit dhe katër komunave, përkatësisht Malishevë, Suharekë, Rahovec dhe Dragash. Masat e ndërmarra në projektin e Fazës 1 në kuadër të "Modelit të Prizrenit" përfshijnë themelimin e një departamenti përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave dhe caktimin e personelit të duhur si dhe vendosjen e taksës së mbeturinave, duke i mundësuar Prizrenit të përmirësojë kapacitetin e tij për menaxhimin e mbeturinave. Nga ana tjetër, në katër komunat e synuara, të cilat gjithashtu ishin

përfshirë si pjesë të projektit në projektin e Fazës 1, nuk u arritën rezultate të ngjashme. Në këtë aspekt, është përcaktuar objektivi i projektit të Fazës 2 për të forcuar kapacitetin e menaxhimit të mbeturinave të MMPHI dhe katër komunave të synuara ku burimet si buxheti dhe personeli janë të kufizuara. Projekti i fazës 2 do të eksplorojë një metodë për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave, e cila mund të zbatohet për komunat e tjera të vogla dhe të mesme me burime të kufizuara në vend.



Trajnim në Japoni

PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS (RTK) FAZA 2

Skema: Bashkëpunimi Teknik

Periudha e projektit:

janar 2021 deri në janar 2024

Organizata homologe:

Radio Televizioni i Kosovës (RTK)

Qëllimi i këtij projekti ishte që t'i ndihmonte RTK-së për të mundur saktësi, paanshmëri dhe drejtësi në programimin e saj, duke krijuar kështu një urë komunikimi në këtë vend multietnik në mënyrë që programet e RTK-së të ndiqen nga një gamë e gjerë e njerëzve në Kosovë. Kjo do të bëhej me organizatën e medias publike të Japonisë që ndante njohuritë e saj të akumuluar në teknologji, prodhimin e programeve dhe në mbledhjen dhe raportimin e lajmeve.

Aktivitetet e projektit përfshijnë themelimin e zyrave rajonale të Prizrenit dhe Mitrovicës, zhvillimin e kriterëve të brendshme për prodhimin e drejtë dhe të paanshëm të programit dhe përdorimin e sistemit të arkivit digital. Zyrat e reja rajonale mundësojnë mbulim më të thelluar rajonal dhe formësimin e këtyre informacioneve në lajme dhe programe. Faza 3 e projektit është planifikuar të fillojë në vitin 2024.



RTK në Prizren

PROJEKTI PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ULJEN E RREZIKUT NGA FATKEQËSITË PËRMES SISTEMIT KOMBËTAR INFORMATIV PËR ZJARRET E PYJEVE (NFFIS) DHE ECO-DRR

Skema: Bashkëpunimi Teknik

Periudha e projektit:

mars 2021 deri në shkurt 2026

Organizata homologe:

Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Ministria e Punëve të Brendshme

Shfaqja e zjarreve në pyje në Kosovë jo vetëm që ndikon në zvogëlimin e resurseve pyjore dhe biodiversitetit, por vonon rimëkëmbjen e pyjeve dhe gjithashtu mund të shpie në shfaqjen e fatkeqësive të tjera natyrore, siç është erozioni i tokës. Prandaj, zbulimi i hershëm dhe kundërmasat kundër zjarreve në pyje janë shumë të rëndësishme për minimizimin e dëmeve, dhe prandaj një sistem që monitoron tërë vendin duke përdorur fotografi satelitore nga qielli është efektiv.

Për të trajtuar këtë çështje, Kosova ka kërkuar mbështetje nga qeveria japoneze për zbatimin e "Projektit për Ngritjen e Kapaciteteve për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë përmes Sistemit Kombëtar Informativ për Zjarret e Pyjeve (NFFIS) dhe Eco-DRR". Sistemi Kombëtar Informativ për Zjarret e Pyjeve (NFFIS) që është prezantuar në Kosovë është një sistem i integruar Web-GIS për parandalimin e zjarrit dhe paralajmërimin e hershëm, i cili mundëson shkëmbimin e informacioneve me agjencitë përkatëse. Nga ana tjetër, për të realizuar një mjedis të qëndrueshëm dhe rezilient dhe për të ulur rreziqet nga fatkeqësitë, është i domosdoshëm menaxhimi, ruajtja dhe restaurimi i qëndrueshëm i ekosistemeve – i njohur si "Eco-DRR (Ulja e Rrezikut të Katastrofave e bazuar në Ekosistem)". Sistemi Kombëtar Informativ për Zjarret e Pyjeve (NFFIS) që është prezantuar në Kosovë është një sistem i integruar Web-GIS për parandalimin e zjarrit



dhe paralajmërimin e hershëm, i cili mundëson shkëmbimin e informacioneve me agjencitë përkatëse. Nga ana tjetër, për të realizuar një mjedis të qëndrueshëm dhe rezilient dhe për të ulur rreziqet nga fatkeqësitë, është i domosdoshëm menaxhimi, ruajtja dhe restaurimi i qëndrueshëm i ekosistemeve – i njohur si "Eco-DRR (Ulja e Rrezikut të Katastrofave e bazuar në Ekosistem)". Qëllimi i projektit është të forcojë kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë në parandalimin dhe zbutjen e zjarreve në pyje dhe fatkeqësive të tjera natyrore përmes krijimit të NFFIS dhe Eco-DRR.

RRETH JICA-s

Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA) ndihmon dhe mbështet vendet në zhvillim si agjenci ekzekutive e Asistencës Zyrtare Japoneze për Zhvillim (ODA).

Në përputhje me vizionin e saj "Të udhëheqim botën me besim", JICA mbështet zgjidhjen e çështjeve të vendeve në zhvillim dhe atyre në tranzicion duke përdorur mjetet më të përshtatshme të metodave të ndryshme të ndihmës dhe një qasje të kombinuar të orientuar nga rajoni, vendi dhe çështjet.

JICA mbikëqyr administrimin e disa ODA-ve si bashkëpunimi teknik, financimi dhe investimi dhe grantet në mënyrë të integruar, përveç kontributeve për organizatat ndërkombëtare. JICA, një nga agjencitë më të mëdha të ndihmës bilaterale në botë, operon në rreth 140 vende dhe rajone dhe ka afërsisht 100 zyra jashtë shtetit.

Bashkëpunimi Teknik

Për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe formulimin e sistemeve administrative të vendeve në zhvillim, bashkëpunimi teknik përfshin dërgimin e ekspertëve, ofrimin e pajisjeve të nevojshme dhe trajnimin e personelit nga vendet në zhvillim në Japoni dhe vende të tjera. Planet e bashkëpunimit mund të përshtaten për të adresuar një gamë të gjerë çështjesh.



Takim me homologët - Projekti për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit - Faza 2



Trajnim me homologët në Japoni - Projekti për zhvillimin e kapaciteteve të Radio Televizionit të Kosovës - Faza 2

Bashkëpunimi për financa dhe investime

HUAJA E ODA

Huatë ODA mbështesin vendet në zhvillim duke ofruar mjete me interes të ulët, me afat të gjatë dhe me koncesion. Huatë ODA përdoren për infrastrukturë në shkallë të gjerë dhe forma të tjera zhvillimi që kërkojnë mjete të konsiderueshme.



Faza 2 e Projektit të Sistemit të Transportit Masiv të Delhi (Indi)

FINANCIMI I INVESTIMEVE NË SEKTORIN PRIVAT

JICA mbështet përsheptimin e rritjes ekonomike/sociale të vendeve në zhvillim nëpërmjet sektorit privat, nëpërmjet investimeve të borxhit dhe kapitalit për projektet zhvillimore të kompanive private.

Grantet

Grantet janë dhënia e fondeve për vendet në zhvillim që kanë nivele të ulëta të ardhurash, pa detyrim ripagimi. Grantet përdoren për përmirësimin e infrastrukturës bazë si shkollat, spitalet, objektet e furnizimit me ujë dhe rrugët, si dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe mjekësor, pajisjeve dhe përmbushjen e kërkesave tjera.



Projekti për Përmirësimin e Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta

Ndihma gjatë fatkeqësive

Kërkimi

Bashkëpunimi përmes pjesëmarrjes qytetare

* Programet e zbatueshme dhe bashkëpunimi ndryshojnë nga vendi në vend

RRETH ZYRËS SË JICA BALLKAN

Themeluar në vitin 2006 në Beograd, Serbi, Zyra JICA Ballkan mbulon Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Zyra JICA Ballkan ndihmon me rritjen dhe stabilitetin për vendet e rajonit dhe nxit promovimin e bashkëpunimit rajonal midis vendeve, duke punuar kryesisht në fushën e ruajtjes së mjedisit, uljen e rrezikut nga fatkeqësitë, zhvillimin e sektorit privat dhe konsolidimin e paqes.

* Qeveria e Japonisë e njohu Kosovën si shtet të pavarur me 18 mars 2008.

Ndryshimi i fundit: Mars 2024

**AGJENCIA JAPONEZE
E BASHKËPUNIMIT
NDËRKOMBËTAR ZYRA BALLKAN**

Qendra e Biznesit USCE, kati i 17-të
Bulevar Mihajla Pupina 6, 11070 Beograd, Serbi

TEL: +381-(0)11-4350-400

www.jica.go.jp/balkan/english/office/index.html

Facebook: www.facebook.com/jicabalkanoffice/

